REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2338 Prot.

Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.82, datë 25.06.2026
"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.73 DATË 29.05.2026 PËR "FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "PALLATI I KULTURËS "DHIMITËR ORGOCKA" DHE RIKONSTRUKSION + PALESTËR SHKOLLA E MESME MALIQ"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma "b" dhe "c" nenit 23, pika 7, nenin 55 "*Votimi"*pika 2 neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" gërma "c" dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik"*, i ndryshuar, projektit të hartuar nga Sektori i Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për objektin "Pallati i Kulturës *"Dhimitër Orgocka"*dhe rikonstruksion palestër shkolla e mesme Maliq, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Fillimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka" dhe Rikonstruksion + Palestër Shkolla e Mesme Maliq, sipas listës së pasurive, planeve të rilevimit dhe projektit që i bashkëlidhen këtij vendimi, si më poshtë:
   - Pasuria nr.1/209, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 300 m^2.
   - Pasuria nr.1/51, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 530 m^2.
2. Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet për shpronësim për interes publik dhe dërgimin e kërkesës zyrtare pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, Tiranë.
3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro **21**
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Orpildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ